



Shqipëria avancon me hapjen e negociatave për 8 kapituj të rinj në BE

Në Bruksel, Shqipëria bëri një hap të rëndësishëm drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian me nisjen e negociatave për 8 kapituj të Grupimit 3, që lidhen me Konkurrueshmërinë dhe Rritjen Gjithëpërfshirëse. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, përfaqësuar nga zëvendësministrat Sokol Duma dhe Olta Manjani, po udhëheq negociatat për kapitujt 19 dhe 20, që fokusohen në Politikën Sociale, Punësimin, Ndërmarrjet dhe Politikën Industriale. Ky proces shënon një përparim të rëndësishëm drejt ndërtimit të një tregu modern, ku zhvillimi ekonomik shoqërohet me mirëqenien sociale dhe mbrojtjen e punëtorëve, duke theksuar rolin udhëheqës të institucioneve shqiptare në reforma thelbësore.

SHQIPËRIA DHE FRANCA FORCOJNË PARTNERITETIN PËR INOVACIONIN DIGJITAL DHE AI TË GJELBËR



Firmoset Planit i Veprimit për Inovacionin nga Ministria franceze e Inovacionit, znj. Clara Chappaz dhe Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, z. Blendi Gonxhja. Ky partneritet strategjik përfaqëson një moment historik për ambicien tonë që Shqipëria të shndërrohet në një qendër evropiane për Inteligjencën Artificiale të gjelbër. Me fokus në Green AI, superkompjuterë, qendra të dhënash dhe kampuse digjitale, ky është një vizion konkret për të ardhmen që sapo ka nisur.

HOLLYWOOD NË SHQIPËRI – NJË KAPITULL I RI PËR INDUSTRIJË FILMIKE SHQIPTARE

Shqipëria mirëpriti një panel të nivelit të lartë me emra të njohur të industrisë globale të filmit si NBCUniversal, Warner Bros/HBO, Amazon MGM Studios dhe Motion Picture Association. Në qendër të diskutimit ishte angazhimi i Shqipërisë për të ndërtuar një ekosistem konkurrues për industrinë kreative përmes stimuljeve fiskale, reformave ligjore dhe investimeve strategjike. Me mbështetjen e Catalyst Story Institute dhe hapjen e Tirana Training Institute, Shqipëria po bëhet një pikë referimi për prodhimet ndërkombëtare dhe zhvillimin e talenteve të reja në film dhe media.



GIRO D'ITALIA NË SHQIPËRI: NJË MOMENT HISTORIK PËR SPORTIN DHE KULTURËN



Për herë të parë në historinë e saj, Shqipëria mirëpriti njërën nga ngjarjet më prestigjioze të çiklizmit botëror, Giro d'Italia, duke e vendosur vendin në hartën globale të sportit. Me një atmosferë festive në zemër të Tiranës, ku u prezantuan 180 çiklistë nga e gjithë bota, kjo ngjarje nisi me një mbrëmje magjike që përfshinte performanca artistike si “Vallen në Garë” nga Ansambli Kombëtar, “Melodia e Zemrës” nga Kori i TKOBAP dhe kitaristi Aurel Gjini, si dhe grupi modern “World of Dance”. Festa e madhe e sportit, kulturës dhe mikpritjes shqiptare vazhdoi në datat 9 maj në Durrës, 10 maj në Tiranë dhe 11 maj në Vlorë, duke e kthyer këtë aktivitet në një moment historik për vendin.

MINISTRI BLENDI GONXHJA MIRËPRITI LIDERËT EUROPIANË NË SHQIPËRI PËR SAMITIN EPC

Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Blendi Gonxhja, mori pjesë në pritjen solemne në Aeroportin Nënë Tereza për Presidentin e Ukrainës, Volodymyr Zelenskyy, Kryeministrin e Hollandës, Dick Schoof, Presidenten e Parlamentit Europian, Roberta Metsola, si dhe Presidenten e Moldavisë, Maia Sandu. Kjo mirëpritje në kuadër të Samitit të Komunitetit Politik Europian (EPC) nënvizon rolin gjithnjë e më aktiv dhe angazhimin e Shqipërisë në nismat dhe zhvillimet kyçe të politikës europiane.



Shqipëria në Bienalen e 19-të Ndërkombëtare të Arkitekturës në Venecia me pavijonin “Building Architecture Culture”

Shqipëria shënoi një prezencë të rëndësishme në skenën ndërkombëtare të artit dhe arkitekturës me pjesëmarrjen në Bienalen e 19-të Ndërkombëtare të Arkitekturës në Venecia. Pavijoni shqiptar, i kuruar nga Anneke Abhelakh dhe i përrurua në prani të kuratorit Carlo Ratti, prezanton temën “Building Architecture Culture”, një reflektim mbi arkitekturën si mjet dialogu, përfshirjeje dhe transformimi shoqëror. Me pjesëmarrjen e emrave të njohur botërorë si Bjarke Ingels dhe Winy Maas, pavijoni thekson rëndësinë e arkitekturës në zhvillimin ekonomik, identitetin kulturor dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në Shqipëri. Ekspozita do të qëndrojë e hapur për publikun nga 10 maji deri më 23 nëntor 2025, falë bashkëpunimit me AKPT dhe AZHT.



Partneritet i fortë për zhvillim të qëndrueshëm kulturor dhe urban në Shqipëri

Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) është një partner kyç në nxitjen e transformimeve të qëndrueshme në fushat e kulturës, edukimit dhe zhvillimit urban në Shqipëri. Në një takim mes Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Ekonomisë, Blendi Gonxhja, dhe Michael Granoff, Kryetar i Bordit të AADF, u diskutuan projektet e përbashkëta që kanë kontribuar në ruajtjen dhe promovimin e identitetit kulturor shqiptar, si dhe mundësitë e reja për thellimin e partneritetit me qëllim avancimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe modernizimin e sektorit kulturor në vend.

TAKIM DYPALËSH SHQIPËRI-FRANCË PËR PLANIN E VEPRIMIT NË INOVACION



Ministrja franceze e Inovacionit, Clara Chappaz, së bashku me Ministrin Gonxhja zhvilluan një takim të rëndësishëm me drejtuesit e institucioneve kryesore të ekosistemit të inovacionit në Shqipëri. Marrëveshja Dypalëshe për Planin e Veprimit për Inovacionin përfaqëson një hap kyç drejt ambicies së Shqipërisë për t'u bërë një qendër evropiane e inteligjencës artificiale të gjelbër dhe inovacionit të qëndrueshëm. Diskutimet u fokusuan në projekte konkrete si Fabrika AI, kampusi digjital, superkompjuterët dhe Qendra BCC në Korçë. Partneriteti me Francën synon të fuqizojë bashkëpunimin akademik, tërheqjen e investimeve dhe zhvillimin e ekonomisë kreative në vend.

SHQIPËRIA PROMOVON TË RINJTË DHE GRATË NË PUNËSIM NË SAMITIN RAJONAL TË MESDHEUT

Zëvendësministrja e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, znj. Olta Manjani, përfaqësoi Shqipërinë në takimin e 18-të të Platformës Rajonale të Unionit për Mesdheun në Porto, Portugali, më 6-7 maj 2025. Ky samit, i organizuar nga Komisioni Evropian në përgatitje të Ministerialit të Maltës në tetor, u fokusua në të ardhmen e punës, zhvillimin e aftësive dhe talentëve në rajon. Diskutimet theksuan rëndësinë e përfshirjes së të rinjve dhe grave në tregun e punës, promovimin e aftësive bazë dhe teknologjike, tranzicionin drejt ekonomisë së gjelbër dhe digjitale, si dhe nevojën për dialog social dhe mbështetje për sipërmarrjen.



HAPET THIRRJA PËR PJESËMARRJE NË TRYEZAT E PARTNERITETIT PËR REFORMËN NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

Hapet thirrja për shprehje interesi për të marrë pjesë në Tryezat e Partneritetit për Reformën në Administratën Publike (PPIE), ku ftohen të gjithë aktorët e shoqërisë me ekspertizë dhe interes në fushat e kapitujve kyç të negociatave, përfshirë lëvizjen e lirë të mallrave dhe punëtorëve, të drejtat e shoqërive, pronësinë intelektuale, politikat sociale dhe punësimin, ndërmarrjet, mbrojtjen e konsumatorit, marrëdhëniet me jashtë dhe të tjera. Për të aplikuar, kërkohet një letër interesi ku specifikohet tryeza përkatëse dhe një CV që tregon eksperiencën ose interesin për kontribut. Synimi i PPIE është të rrisë informimin, komunikimin dhe përfshirjen aktive të aktorëve jo-shtetërorë në procesin e reformave administrative.



EKSPORTET SHQIPTARE SHËNOJNË RITJE NË 4 MUAJT E PARË TË 2025



Eksportet shqiptare për periudhën Janar-Prill 2025 arritën vlerën prej 133 miliardë lekësh, duke shënuar një rritje prej 2,3% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rreth 67,4% e eksporteve u drejtuan drejt vendeve të Bashkimit Europian, duke konfirmuar rëndësinë kyçe të këtij tregu për ekonominë shqiptare. Rritjet më të mëdha janë regjistruar në sektorë si mineralet, lëndët djegëse dhe energjia elektrike (+8,9 pikë përqindje), ushqimet, pijet dhe duhani (+0,6), si dhe makineritë dhe pjesët këmbimi (+0,5).

SHQIPËRIA FORCON ROLIN NË LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT TË PALIGJSHËM TË OBJEKTEVE KULTURORE NË UNESCO



Në Takimin e 8-të të Shteteve Palë të Konventës së UNESCO-s 1970, delegacioni shqiptar, përbërë nga Përfaqësues të UNESCO-së, MEKI-së dhe Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm në Tiranë, ndau përvojën dhe angazhimin e vendit në luftën kundër trafikimit të paligjshëm të objekteve kulturore. Ambasadorja pranë UNESCO, znj. Besiana Kadare, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar, duke sjellë në vëmendje rastin e rikthimit të 20 ikonave të trafikuara ilegalisht në dhjetor 2023 në Maqedoninë e Veriut. Shqipëria gjithashtu kontribuoi në hartimin e një rezolute të re për forcimin e kapaciteteve dhe parandalimin e këtij fenomeni global, duke theksuar angazhimin e saj si një zë i fuqishëm në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

SHQIPËRIA DHE SLLOVENIA NISIN NEGOCIATAT PËR NJË MARRËVESHJE HIBRIDE MBI PUNËSIMIN DHE SIGURIMET SHOQËRORE

Në Lubjanë, Shqipëria dhe Sllovenia kanë nisur zyrtarisht negociatat për një marrëveshje të re bashkëpunimi në fushën e punësimit dhe sigurimeve shoqërore. Pala shqiptare përfaqësohet nga Zëvendësministria Olta Manjani, ndërsa ajo sllovene nga Sekretari i Shtetit, Igor Feketija. Qëllimi i marrëveshjes është garantimi i të drejtave të qytetarëve shqiptarë dhe sllovenë për përfitime si pensioni i pleqërisë dhe ruajtja e viteve të punës, duke forcuar mobilitetin dhe sigurinë sociale ndërkufitare.



“ALBANIA FUTURE NOW” – SHQIPËRIA DREJT NJË TË ARDHMEJE INOVATIVE

Në Samitin ACT NOW 2025, u lançua zyrtarisht fushata “Albania Future Now”, një nismë e përbashkët e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe EU4Innovation, e zbatuar nga GIZ Shqipëri. Qëllimi: promovimi i Shqipërisë si një qendër rajonale inovacioni. Shqipëria po afirmohet me avantazhe konkrete: potencial të lartë njerëzor, kosto konkurruese, infrastrukturë moderne, komunitet kreativ dhe pozicion strategjik. Me mbështetjen e partnerëve vendas dhe ndërkombëtarë, janë përcaktuar shtyllat themelore që e vendosin vendin tonë në epiqendër të zhvillimeve teknologjike dhe kreative në rajon.



NIS RESTAURIMI I KALASË SË KANINËS

Kanina po hyn në një fazë të re zhvillimi! Në kalanë historike kanë nisur punimet konservuese dhe restauruese që do të ruajnë trashëgiminë dhe do të sjellin një përvojë të re për vizitorët. Projekti, që realizohet nga Proskene dhe CHwB Albania me mbështetjen e FSHZH dhe Bankës Botërore, përfshin ndërhyrje strukturore, përmirësim të interpretimit kulturor dhe krijimin e hapësirave të reja mikpritëse. Kalaja do të qëndrojë e mbyllur deri më 25 prill 2026, për t’u rihapur më pas më e sigurt dhe më mbresëlënëse se kurrë.





SHQIPËRIA, LIDERE NË EKONOMINË KREATIVE NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Në Takimin Ministerial të Procesit të Berlinit për Ekonominë Kreative në Kotor, Shqipëria u vlerësua për rolin udhëheqës në këtë sektor, duke u prezantuar si shembull i qeverisjes së zgjuar dhe zhvillimit të qëndrueshëm. U shpall Paketa e Përkrahjes për Ekonominë Kreative dhe u theksua rëndësia e ngritjes së Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Brenda të njëjtit kuadër, u nënshkrua Marrëveshja për Strategjinë Kombëtare të Ekonomisë Kreative me British Council, me kontributin e ekspertëve ndërkombëtarë. Strategjia do të përfshijë reforma në kinematografi, media, dizajn, turizëm kulturor dhe punësim të të rinjve. Me potencial për të krijuar deri në 70,000 vende pune dhe 700 milionë euro të ardhura, ky sektor po kthehet në një motor zhvillimi ekonomik për Shqipërinë.

SHQIPËRI – MOLDAVI: HAP DREJT BASHKËPUNIMIT SOCIAL DHE INTEGRIMIT EVROPIAN

Shqipëria dhe Moldavia nisën negociatat për një Marrëveshje Kuadër në fushën e sigurimeve shoqërore dhe pensione, me qëllim njohjen e ndërsjellë të viteve të punës dhe garantimin e përfitimeve si pensioni i pleqërisë, invaliditetit dhe ai familjar për qytetarët në të dyja vendet. Kjo nismë, e ndërmarrë në frymën e bashkëpunimit evropian pas nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit për integrimin evropian, forcon lidhjet mes dy vendeve dhe rrit mbrojtjen sociale të qytetarëve.



SHQIPËRIA NËNSHKRUAN MARRËVESHJE ME IFC PËR PARQET ECO-INDUSTRIALE DHE ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM



Shqipëria hodhi një hap të rëndësishëm drejt zhvillimit industrial të qëndrueshëm me marrëveshjen me IFC për Parqet Eco-Industriale. Ky projekt synon transformimin e zonave industriale si Uzina Metalurgjike në Elbasan dhe Kombinati në Tiranë në qendra inovacioni me teknologji të gjelbër, duke përforcuar politikat industriale dhe nxitur investimet private. Me mbështetjen e Bashkimit Evropian, kjo iniciativë përkrah tranzicionin e gjelbër dhe integrimin në Bashkimin Evropian.